



01/Nr. 6564/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-48 neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49 neni 2, Qarkoret Buxhetore 2022/01 me nr. 797/2021 dhe 2022/02 me nr.1206/2021 për Komunat, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 28.09.2021 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2023-2024 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 është në shumë prej 2,759,758 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2023 janë në shumë prej 2,903,855€ dhe për vitin 2024 janë në shumë prej 3,039,398 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2022 sipas pikës (1) të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,378,411 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 86.18%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 381,347 € apo 13.82%.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe shtesa 1,756,083 €, mallra dhe shërbime 385,975 €, shpenzime komunale 67,700 €, subvencione dhe transfere 80,000 € dhe shpenzime kapitale 470,000 €.
4. Pjesë përbërse të këtij vendimi janë tabelat e buxhetit për vitet 2022-2024 (tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3).
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Data : 28.09.2021
Hani i Elezit



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



01/Nr. 7219 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 neni 11 paragrafi 11.2, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.09.2021 merr:

V E N D I M
PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Sherif Lusnjani sipas kërkesës së tij.
2. Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 150 m², në vendin e quajtur "Fusha" zona kadastrale Gorancë, me kulturë livadh i klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të z. Sherif Lusnjani, sipas certifikatës pronësore P-73317019-01538-1.
3. Parcela e lartë shënuar gjendet në planin zhvillimor komunal dhe është në zonën ndërtimore, andaj u vendos që destinimi i pronës me kulturë livadh i klasit të pestë (5), të bëhet parcelë ndërtimore.
4. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtim për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Parashtruesi i Kërkesës,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër,
- Drejtoria për Bujqësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 28.09.2021



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



01/ Nr.7005/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.09.2021 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
2. Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

Vendimet/Çështjet

JANAR
2022

- Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
- Themelimi i Komitetit për Politik dhe Financa.
- Themelimi i Komitetit për Komunitete.
- Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.
- Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2022.
- Njoftimit i kuvendit të komunës rreth përbërjes së KKSB-së.
- Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi 2022.
- Caktimi i kritereve për shpalljen e konkursit për katër komitetet konsultative të komunës së Hani të Elezit.
- Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hani të Elezit.
- Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.

SHKURT
2022

- Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.
- Raporti financiar për vitin 2021.
- Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
- Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.
- Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.
- Raporti financiar për vitin 2021 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
- Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

MARS 2022,	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021. • Raportet e punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2021. • Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
PRILL 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Informatë për ndarjen e bursave. • Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
MAJ 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2022. • Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit. • Shqyrtimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
QERSHOR 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza afatmesme buxhetore 2023-2025. • Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal. • Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2023.
KORRIK 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2022. • Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2021. • Plani i Veprimt të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2021. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2021. • Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022. • Informatë për sektorin e emergjencave.
GUSHT 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2022. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021-2022. • Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023. • Informatë për korrjet shirjet.
SHTATOR 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025. • Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023. • Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.
TETOR 2022	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022. • Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Hanit të Elezit • Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2023. • Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML. • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.

NËNTOR
2022

- Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
- Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

DHJETOR
2022

- Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.

4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2022, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.
5. Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
6. Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.
7. Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
8. Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën tre (3) të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.
9. Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2022, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2022.
10. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohet:

Kryetari i Komunës,
Drejtorët e Drejtorive,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
Shërbimi i Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.09.2021

